

Majlinda PEZA-PERRIU

Universiteti European i Tiranës

Email: majlinda.perriu@uet.edu.al

ORCID: <https://orcid.org/0000-0002-4846-7609>

KUD: 32:929(496.5)Vlora, familje(05)

&

Ilirjana KACELI-DEMIRLIKA

Universiteti i Shkodrës “Luigj Gurakuqi”

Email: ilirakaceli@gmail.com

ORCID: <https://orcid.org/0000-0002-8228-9789>

KUD: 32:929(496.5)Vlora, familje(05)

**VEPRIMTARIA POLITIKE DHE DIPLOMATIKE E FAMILJES
VLORA NË PRAG TË PAVARËSISË SË SHQIPËRISË****Abstrakt:**

Ky punim trajton veprimtarinë politike dhe diplomatike të familjes Vlora në prag të shpalljes së pavarësisë së Shqipërisë në nëntor të vitit 1912, duke u ndalur veçanërisht tek dy figurat më të spikatura të kësaj familjeje: Syrja bej Vlora dhe Ismail Qemal bej Vlora. Duke qenë dy personalitete kyçe të elitës politike shqiptare në fillim të shekullit XX, ata zhvilluan një aktivitet paralel, shpeshherë konkurrues dhe në disa momente kundërshtarë, për orientimin e lëvizjes kombëtare drejt zgjidhjes politike dhe organizimin e një Kuvendi Kombëtar. Studimi analizon rolin e Syrja bej Vlorës në krijimin e kontakteve diplomatike me Austro-Hungarinë, duke u përpjekur të siguronte mbështetjen e Vjenës për autonominë e Shqipërisë brenda Perandorisë Osmane, ose për pavarësinë e saj në rast të kolapsit të shtetit osman nën presionin e Luftës së Parë Ballkanike. Përmes burimeve të ndryshme punimi nxjerr në pah rolin e tij në nxitjen e parisë shqiptare që të organizonte një kuvend kombëtar në një nga qytetet, Vlorë, Durrës apo Elbasan, me synim koordinimin e reagimit politik shqiptar ndaj kërcënimit të copëtimit territorial nga shtetet fqinje ballkanike. Përpjekjet e Syrja bej Vlorës për të mobilizuar krerët shqiptarë përfshinte komunikime intensive me qendrat e Shqipërisë së Jugut dhe të Mesme, por edhe takime të nivelit të lartë me personalitete të diplomacisë austriake. Në të njëjtën kohë, analizohet veprimtaria e Ismail Qemalit, i cili ndërmoi një ofensivë diplomatike në Vjenë e Budapest, me synimin e sig-

urimit të mbështetjes ndërkombëtare për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë jashtë çdo ndikimi osman. Punimi shqyrton vështirësitë e shumta që penguan mbledhjen e Kuvendit në qytete të ndryshme, kundërshtitë lokale, mungesën e një mbështetje të unifikuar, interesat krahinore dhe ndërhyrjet ndërkombëtare, si dhe mënyrën sesi këto dinamika çuan përfundimisht në mbledhjen e Kuvendit Kombëtar në Vlorë më 28 nëntor 1912 nën drejtimin e Ismail Qemalit. Analiza arrin në përfundimin se megjithëse të dyja degët e familjes Vlora kontribuan ndjeshëm në procesin shtetformues, mungesa e bashkëpunimit dhe rivaliteti politik e bëri të vështirë koordinimin kombëtar në një moment vendimtar historik. Ky rivalitet pasqyron më gjerë tiparet e elitës politike shqiptare të fillim shekullit XX, ku interesat personale dhe krahinore shpesh mbizotëronin mbi interesin kombëtar. Pengesat e shumta që lindën në qytete si Durrësi, Tirana dhe Elbasani nga kundërshtitë lokale, tensionet fetare, interesat krahinore si dhe nga ndërhyrjet e drejtpërdrejta apo të tërthorta të fuqive të huaja bënë që në fund Kuvendi Kombëtar të mbledhej në Vlorë më 28 Nëntor 1912 nën drejtimin e Ismail Qemalit. Studimi arrin në përfundimin se, ndonëse të dy figurat e familjes Vlora kontribuan në mënyra të ndryshme dhe të rëndësishme në procesin e shtetformimit shqiptar, rivaliteti i tyre politik përfaqëson më gjerë problemet e brendshme të elitës politike shqiptare të asaj periudhe, ku përplasja e interesave personale, fisnore dhe rajonale shpesh ndikonte negativisht ndaj interesit kombëtar. Megjithatë, pavarësisht mosmarrëveshjeve, veprimtaria e tyre e kombinuar dhe presioni i rrethanave historike çuan në konkretizimin e një prej akteve më të rëndësishme të historisë shqiptare Shpalljen e Pavarësisë.

Fjalë kyçe: Familja Vlora, rivaliteti politik, Kuvendi Kombëtar, elitë politike.

Abstract:

This paper examines the political and diplomatic activity of the Vlora family on the eve of Albania's declaration of independence in November 1912, focusing particularly on the two most prominent figures of the family: Syrja Bey Vlora and Ismail Qemal Bey Vlora. As two key personalities of the Albanian political elite in the early 20th century, they carried out parallel, often competitive, and at times opposing activities in directing the national movement toward a political solution and the organization of a National Assembly. The study analyzes the role of Syrja Bey Vlora in establishing diplomatic contacts with Austria-Hungary, seeking to secure Vienna's support for

Albania's autonomy within the Ottoman Empire, or for its independence in case of the Ottoman state's collapse under the pressure of the First Balkan War. Through various sources, the study highlights Syrja Bey Vlora's role in encouraging the Albanian elite to organize a national assembly in one of the cities - Vlora, Durrës, or Elbasan - with the aim of coordinating the Albanian political response to the threat of territorial dismemberment by neighboring Balkan states. Syrja Bey Vlora's efforts to mobilize Albanian leaders included intensive communications with the centers of southern and central Albania, as well as high-level meetings with personalities from the Austrian diplomatic corps. At the same time, the study examines the activity of Ismail Qemal, who undertook a diplomatic offensive in Vienna and Budapest with the aim of securing international support for Albania's declaration of independence, free from any Ottoman influence. The study examines the numerous difficulties that hindered the convening of the Assembly in various cities, including local opposition, the lack of unified support, regional interests, and international interventions, as well as how these dynamics ultimately led to the gathering of the National Assembly in Vlora on November 28, 1912, under the leadership of Ismail Qemal. The analysis concludes that although both branches of the Vlora family contributed significantly to the state-building process, the lack of cooperation and political rivalry made national coordination difficult at a decisive historical moment. This rivalry reflects more broadly the characteristics of the Albanian political elite in the early 20th century, where personal and regional interests often prevailed over the national interest. The multiple obstacles that arose in cities such as Durrës, Tirana, and Elbasan - due to local opposition, religious tensions, regional interests, and direct or indirect interventions by foreign powers - ultimately led to the convening of the National Assembly in Vlora on November 28, 1912, under the leadership of Ismail Qemal. The study concludes that although both figures of the Vlora family contributed in different and significant ways to the Albanian state-building process, their political rivalry reflects the broader internal problems of the Albanian political elite of that period, where clashes between personal, familial, and regional interests often negatively affected the national interest. Nevertheless, despite disagreements, their combined efforts and the pressure of historical circumstances led to the realization of one of the most important acts in Albanian history: the Declaration of Independence.

Keywords: Vlora family, political rivalry, National Assembly, political elite.

Hyrje

Me fillimin e Luftës së Parë Ballkanike, në qendër të veprimtarisë për krijimin e shtetit shqiptar qëndronte edhe kushëriri dhe njëkohësisht rivali i Ismail Qemal bej Vlorës, Syrja bej Vlora, së bashku me të birin 27-vjeçar, Eqerem bej Vlorën¹. Syrja beu kishte krijuar kontakte të rëndësishme diplomatike për organizimin e një mbledhjeje të madhe me përfaqësues të popullit dhe krerëve shqiptarë nga të gjitha krahinat e Shqipërisë, ku do të vendosej për qëndrimin që do të mbahej gjatë ngjarjeve të pritshme të vjeshtës së vitit 1912².

Për këtë problem, Eqerem bej Vlora shkruante: *Im atë u lidh me njerëz në Vlorë, në Gjirokastrë dhe Berat, ai shkroi letra dhe dërgoi lajmësa ngado. Mirëpo, për domosdoshmërinë e kësaj mbledhjeje nuk ishin të bindur as përkrahësit tanë më të afërt, pa folur këtu kundërshtarët. Në veçanti, kundërshtarët tanë, krejt specialë, të Vlorës thoshin se nuk mund të merrej asnjë vendim pa dëgjuar më parë se ç'thotë për këtë punë Ismail Qemal beu (se fundja ishte ai i pari i familjes Vlora). Që në fund të vitit 1911 disa prej tyre e kishin takuar politikanin plak në Korfuz dhe tregonin se ai kishte folur për kryengritje, por nuk kishte përmendur asnjë fjalë për nevojën e thirrjes në vend të ndonjë mbledhjeje³. Veprimtaria e Syrja bej Vlorës u intensifikua gjatë vjeshtës së vitit 1912, si pasojë e rrethanave të reja të krijuara nga fillimi i ofensivave ushtarake të shteteve ballkanike kundër trojeve shqiptare në kuadër të Luftës së Parë Ballkanike.*

Aspekte të veprimtarisë politike dhe diplomatike të Syrja bej Vlorës dhe Ismail bej Vlorës për shpalljen e pavarësisë së Shqipërisë.

Nga fundi i shtatorit të vitit 1912, Eqerem bej Vlora (i biri i Syrja bej Vlorës) shkoi në Vjenë. Atje ai zhvilloi disa takime të rëndësishme me për-

¹ Ilir Ikonomi. *Pavarësia, udhëtim i paharruar i Ismail Qemalit*, Tiranë, UET Press, 2012, f. 43.

² Eqerem bej Vlora. *Kujtime*, vëllimi i parë 1885-1912, Tiranë, Shtëpia e Librit dhe Komunikimit, 2001, f. 296-297. Që në vitin 1911 Syrja bej Vlora shkruante rreth organizimit të dobët të ushtrisë osmane, që lidhej me nivelin e pamjaftueshëm të armatimit, duke vënë seriozisht në dyshim pathyeshmërinë e saj. Për më tepër, një mendim i tillë u përforcua edhe më shumë pas luftës turko-italiane, që përfundoi me humbjen e Perandorisë Osmane dhe kalimin e Tripolit në duart e Italisë.

³ Eqerem bej Vlora. *Kujtime*, vëll. I, 1885-1912, f. 296.

faqësuesit më të njohur të diplomacisë vjeneze, sikurse ishin: shefi i seksionit, kryekonsulli Alfred Rappaport, njohës i mirë i çështjes shqiptare; konti Berchtold, ministër i Punëve të Jashtme të Austro-Hungarisë dhe shefi i shtabit të përgjithshëm, konti Konrad fon Hëtcendorf. Pas kthimit të tij në Vlorë në ditët e para të tetorit 1912, në Vjenë do të shkonte i ati i tij, Syrja bej Vlora. Me fillimin e Luftës së Parë Ballkanike, në rrethin e gjerë të politikanëve austriakë, ekzistonte mendimi se Perandoria Osmane do ta përballonte me sukses sulmin e aleatëve ballkanikë. Të njëjtin mendim ndante edhe konti Berchtold, madje duke qenë mëse i bindur, se ushtritë turke do të mobilizoheshin shumë më shpejt nga sa pritej për të siguruar fitoren e pritshme. Por ndërkaq, në parashtrimin e bërë nga Syrja bej Vlora rreth situatës së krijuar në Ballkan, në prezencë edhe të kontit Berchtold, shprehej bindja e tij, se Perandoria Osmane nuk do të mund ta rimerrte më veten. Në këtë takim, Syrja bej Vlora pohon t'i ketë paraqitur kontit Berchtold dy kërkesa kryesore; së pari, mbështetjen e Vjenës për të siguruar autonominë e Shqipërisë, në rast se ushtritë turke dilnin fitimtare në përballjen me ushtritë e shteteve ballkanike dhe së dyti, mbështetjen e diplomacisë vjeneze në funksion të pavarësisë së Shqipërisë, në rast të mundjes së Perandorisë Osmane nga Liga Ballkanike⁴.

Sikurse shkruan në kujtimet e tij Syrja bej Vlora, ai mori garancinë e diplomatit vjenaz se tashmë, kishte ardhur koha që shqiptarët duhej të fitonin të drejtat e tyre kombëtare, duke i parashtruar Syrja beut njëkohësisht edhe kufijtë brenda të cilëve duhej të krijoheshin Shqipëria⁵. Gjithashtu, ai arriti të sigurojë edhe një sasi të konsiderueshme armësh të tipit *Manhiler-Schonauer*, të cilat ishin planifikuar të dërgoheshin shumë shpejt në Shqipëri përmes një shoqërie tregtare austriake. Për të sensibilizuar opinionin hungarez në favor të çështjes shqiptare, Syrja beu i kushtoi rëndësi të posaçme daljes në një konferencë shtypi në Deutscher Herren Club, pas së cilës, shtypi i Vjenës u mbush me artikuj ku theksohej se mbrojtja e ekzistencës së Shqipërisë përbënte një garanci për ruajtjen e ekuilibrit në Ballkan⁶. Syrja beu do të përmendte gjithashtu takimin që ai pati me arqidukën Franc Ferdinand, pikëpamjet e të cilit, sipas tij, përkonin plotësisht me ato të Syrja beut. Arqiduka Franc Ferdinand ishte mëse i bindur se shumë shpejt Turqia do të shembej, duke krijuar koniunktura të reja në Ballkan. Pavarësisht se Arqiduka nuk ndante të

⁴ Po aty.

⁵ Syrja Vlora. *Kujtime nga fundi i sundimit osman në Luftën e Vlorës*. (Përgatiti për botim Marenglen Verli e Ledia Dushku), Tiranë, Iceberg Publishing House, 2013, f. 61-62.

⁶ Syrja Vlora. *Kujtime nga fundi i sundimit osman*, f. 63.

njëjtin qëndrim me kontin Berchtold rreth së ardhmes së Turqisë në Ballkan, ata takoheshin në një pikë të përbashkët, në mbështetjen për çështjen shqiptare.

Pas premtimit të marrë nga Vjena zyrtare, Syrja bej Vlora do të niste menjëherë korrespondencën me rrethet patriotike shqiptare për krijimin fillimisht të një komiteti për mbrojtjen e interesave kombëtare, me synim organizimin e një kuvendi kombëtar, ndërkohë që në Vlorë vepronte i biri i tij, Eqerem bej Vlora. Në kuadër të kësaj nisme, më 27 tetor 1912, u lajmëruan me telegram qytetet kryesore të vendit: qytetet Berat, Gjirokastrë, Elbasan, Korçë, Tiranë, Kavajë, Përmet, Leskovik, Delvinë, Tepelenë, Starovë, Lushnjë, Peqin, Krujë, Kolonjë e Skrapar⁷.

Përmes një letre drejtuar vëllezërve Toptani në Tiranë, Syrja bej Vlora kërkonte të dërgoheshin në Vlorë nga çdo prefekturë dy deri në katër përfaqësues⁸. Ai u bënte të ditur vëllezërve Toptani se për këtë kërkesë ishin vënë në dijeni tashmë qytetet e Elbasanit dhe Peqinit, të cilat e kishin marrë njoftimin më herët. Po ashtu, ai kërkonte që të njoftoheshin edhe qytetet Krujë, Shijak, Kavajë, Dibër dhe Mat.

Një informacion i ngjashëm, pasqyrohej gjithashtu edhe në raportet e konsullit austro-hungarez në Vlorë, Lejhanec, i cili njoftonte ambasadorin Pallavicini në Stamboll se më 31 tetor të vitit 1912, qytetet e Shqipërisë së Jugut, si: Berati, Tepelena, Përmeti, Gjirokastra, Delvina etj., që ishin lajmëruar nga Syrja bej Vlora për organizimin e një kuvendi kombëtar në Vlorë, kishin dërguar telegrame përmes së cilave shkruanin se pranonin të dërgonin delegatë në kongres⁹.

Gjithashtu, për t'u informuar rreth situatës në Shqipërinë e Veriut, si dhe për të njoftuar edhe atje për thirrjen e kuvendit kombëtar në Vlorë, më 31 tetor 1912 Syrja bej Vlora do të nisej përmes detit nga Vlora për në Durrës. Faktikisht, ai do ta ndryshonte itinerarin e tij, duke e vazhduar udhëtimin drejt Shëngjinit për në Shkodër¹⁰. Pasi mbërriti në Shkodër më 1 nëntor 1912, Syrja bej Vlora

⁷ Syrja Vlora, *Kujtime nga fundi i sundimit osman.*, f. 66. Telegrami i botuar në librin me kujtime të Syrja bej Vlorës mban datën 27 shtator, por duke e parë në raport me kronologjinë historike të ngjarjeve që ai tregon dhe në raport me dokumentet austro-hungareze, mendojmë se duhet të jetë muaji tetor dhe jo shtator.

⁸ Arkiva Qendrore e Republikës së Shqipërisë (më tej: AQSH). F. 145. Dos. nr. II-27, fl. 11. Në kohën kur është dërguar letra, 31 tetor, Syrja bej Vlora gjendej në vapor në Durrës. Fondi *Syrja Vlora*. Dos. 27, fl. 11.

⁹ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze*, vëll. VI, (Përgatiti për botim Marenglen Verli e Ledia Dushku), Tiranë, Botimet Albanologjike, 2012, f. 93.

¹⁰ Ilir Ikonimi, *Pavarësia, udhëtim i paharruar i Ismail Qemalit.*, f. 66.

u prit nga Esad Pashë Toptani dhe u vendos në banesën e tij. Ai qëndroi në Shkodër deri më 10 nëntor 1912, prej nga u largua sërish me rrugë detare.

Më 2 nëntor të vitit 1912, Syrja bej Vlora u dërgoi një telegram parisë së Elbasanit [*personalisht Aqif Pashë Elbasanit, Shefqet bej Vërlacit, Hasan bej Elbasanit parisë dhe klerit mysliman të Elbasanit*], përmes të cilit parashtronte pikëpamjet e tij dhe i informonte mbi përpjekjet, për organizimin e një kongresi të patriotëve shqiptarë. Qëllimi i kësaj nisme ishte shpallja e autonomisë ose e pavarësisë së Shqipërisë, në varësi të zhvillimeve politike dhe ushtarake në Ballkan, që po ndryshonin në dëm ose në favor të Perandorisë Osmane. Në telegram, Syrja beu kërkonte mbështetjen e parisë së Elbasanit dhe caktimin e përfaqësuesve që duhej të niseshin sa më parë drejt Vlorës.

Përgjigjja nga Elbasani mbërriti më 9 nëntor 1912 dhe iu drejtua Eqerem bej Vlorës, i cili kishte marrë përsipër organizimin e Kuvendit. Ndonëse kërkesa i ishte dërguar Aqif Pashës, Shefqet bej Vërlacit dhe Hasan bej Elbasanit, letra e kthyer mbante firmat e Lef Nosit dhe Grigor Cilkës. Në të, shprehej gatishmëria për pjesëmarrje në mbledhje, megjithëse, siç thuhej aty, “sa do që njoftimit që i bënit Elbasanit nuk i është dhënë ende përgjigjja, jemi gati të marrim pjesë në mbledhje.” Nga përmbajtja e kësaj letre kuptohet se iniciativa e Lef Nosit dhe Grigor Cilkës kishte më shumë karakter individual, ndonëse mund të ishin konsultuar edhe me përfaqësues të tjerë të parisë. Megjithatë, burimet e kohës nuk dëshmojnë se Aqif Pashë Elbasani dhe paria e tij i janë përgjigjur zyrtarisht ftesës së Syrja bej Vlorës. Kjo heshtje mund të lidhet me simpatinë që Aqif Pasha ushqente ndaj Ismail Qemalit, kushëririt dhe rivalit politik të Syrja bej Vlorës.

Në të njëjtën datë, më 9 nëntor 1912, Ismail Qemali, përmes një telegrami të dërguar nga zyra telegrafike e hotelit “Grand”, njoftonte bashkinë e Vlorës: “Arrij me anijen e parë. E ardhmja e Shqipërisë është e garantuar”. Në telegram, Syrja beu kërkonte mbështetjen e parisë së Elbasanit dhe caktimin e përfaqësuesve që duhej të niseshin sa më parë drejt Vlorës¹¹.

Thuajse në të njëjtën kohë, telegrame për organizimin e kuvendit kombëtar vinin nga të dy kushërinjtë por, qëndrimi i parisë së Elbasanit rezultonte më së shumti në mbështetje të Ismail Qemalit¹². Gjithashtu, edhe përfaqësues të tjerë të elitës politike të Elbasanit, nuk nguruan të pozicionoheshin

¹¹ Ilir Ikonomi, *Pavarësia, udhëtim i paharruar i Ismail Qemalit...*, f. 99. Ky telegram dërgohet para se Ismail Qemali të takohej me kontin Berchtold në Budapest.

¹² Besnikëria e Aqif Pashës ndaj Ismail Qemalit u duk qartë përmes mbështetjes së hapur që ai i dha Qeverisë së Vlorës në vitet 1912-1913.

në mbështetje të Syrja bej Vlorës, për të marrë pjesë në kuvendin kombëtar, natyrisht nëse do të organizohej prej tij.

Në ditët e para të nëntorit të vitit 1912, situata në Vlorë nuk ishte e favorshme për mbështetësit e Syrja bej Vlorës. *Ishte e pamundur*, shkruante baronesha Amelie Von Godin, *t'i bashkoje vlonjatët për të marrë vendimin shumë të thjeshtë, për caktimin e ditës së mbledhjes dhe mënyrën e drejtimit të saj*¹³. Pavarësisht vështirësive të shumta, Eqerem bej Vlora [i biri i Syrja bej Vlorës] kishte arritur të njoftonte një pjesë të delegatëve nga qytete të ndryshme shqiptare. Por, zvarritjet në caktimin e datës së mbledhjes së kuvendit dhe vonesat në hartimin dhe dërgimin e programit të kuvendit, krijuan përçarje edhe në parinë e atyre qyteteve që kishin shprehur gatishmërinë për të marrë pjesë në kuvend, sikurse ishin: Berati, Tepelena, Përmeti, Gjirokastra dhe Delvina¹⁴. Në nëntor të vitit 1912, së bashku me Eqerem bej Vlorën dhe delegatët e Beratit, në Vlorë gjendeshin edhe delegatë të Elbasanit, porse nuk jepet ndonjë informacion për sa i përket emrave të tyre¹⁵. Referuar burimeve të kohës, të gatshëm për të vajtur në Vlorë në 9 nëntor 1912 ishin shprehur Lef Nosi dhe Grigor Cilka.

Në Shqipërinë e Mesme, ku Syrja bej Vlora gëzonte mbështetjen e plotë të vëllezërve Toptanas, deri më 10 nëntor të vitit 1912 kishin arritur të grumbulloheshin edhe përfaqësuesit e Shqipërisë së Veriut, të cilët, ishin në pritje të njoftimit të Eqerem bej Vlorës për t'u nisur drejt Vlorës. Por, duke mos pasur mbështetjen e pritur në Vlorë, nisja e tyre u shty për disa ditë. Për më tepër, duhet thënë se në Vlorë ndikim të madh kishin Ismail Qemali dhe përkrahësit e tij, gjë që përbënte një problem tepër shqetësues për Eqerem bej Vlorën. Kjo pasqyrohej qartë edhe në letrën që Eqerem bej Vlora i kishte dërguar konsullit austro-hungarez në Vlorë, më 6 nëntor të vitit 1912, ku ai shprehej tepër i shqetësuar për faktin se në Vlorë mund të mbërrinte Ismail Qemali, që, sikurse shkruante konsulli enzel von Lejhanec: *... mund të kërkojë të marrë në dorë të tij drejtimin e kongresit dhe të ndikojë që vendimet e saj të kenë një drejtim të favorshëm për miqtë e tij politikë të jashtëm*¹⁶. Konsulli

¹³ Ilir Ikonomi, *Pavarësia, udhëtim i paharruar i Ismail Qemalit*, f. 48.

¹⁴ Po aty, f. 83.

¹⁵ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze*, vëll. VI, (Përgatiti për botim Marenglen Verli e Ledia Dushku), (Tiranë: Botimet Albanologjike, 2012), 170.

¹⁶ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze*, vëll. VI, (Përgatiti për botim Marenglen Verli e Ledia Dushku), Tiranë, Botimet Albanologjike, 2012, f. 93. Raport i nënkonsullit Lejhanec në Vlorë për ambasadorin Pallavicini në Stamboll. Ismail Qemali nuk konsiderohej si njeri i

austro-hungarez nuk e konsideronte Ismail Qemalin si njeri të besueshëm të Vjenës zyrtare, duke nënkuptuar edhe mbështetjen që mund të kishte Ismail Qemali nga aktorë të tjerë ndërkombëtarë. Zgjidhjen e situatës së krijuar në Vlorë në nëntor 1912, Eqerem beu e shikonte në praninë e vetë Syrja beut në qytetin e Vlorës. Por vajtja e tij ato ditë në Vlorë ishte shumë e vështirë, sepse rrugët detare apo tokësore ishin të bllokuara nga flota dhe ushtritë ballkanike.

Dy vizione politike për të ardhmen e Shqipërisë: Syrja bej dhe Ismail Qemal Vlorë në vitin 1912

Përmes kontakteve që konsulli austro-hungarez në Durrës kishte pasur me Syrja bej Vlorën, informohemi për udhëtimin e tij drejt Vjenës më 12 nëntor 1912, ku tashmë atje gjendej edhe Ismail Qemali, i cili kishte udhëtuar nga Budapesti për t'u takuar atje me diplomatët vjenezë për çështjen shqiptare¹⁷.

Rreth këtij udhëtimi, baronesha Amelie von Godin shkruante: *Përse shkonte Ismail Qemali në Vjenë? Ismaili kishte vendosur të luante kartën e diplomacisë. Ai kërkonte përkrahjen morale dhe ndoshta materiale të Vjenës. Aq më tepër i duhej konfirmimi i Austrisë tani që ishte bërë e qartë se një grup rival, ai i Syrja bej Vlorës po përpiquej të mobilizonte bejlerët në Shqipëri për ta arritur një qëllim të ngjashëm*¹⁸. Referuar fjalëve të baroneshës, udhëtimi i Ismail Qemalit dhe qëllimi i tij për të vajtur në Vjenë [pavarësisht se nuk shihej si figurë politike e besueshme nga diplomatët vjenezë], më së shumti ishte një kundërpërgjigje ndaj lëvizjeve diplomatike që po bënte në Vjenë Syrja bej Vlorë, i cili po përpiquej të merrte garanci të plota për organizimin e një Kongresi Kombëtar, për më tepër, kur dihej orientimi dhe prirjet e tij austrofile [duke qenë një nga njerëzit më të besuar të Vjenës zyrtare].

Gjithashtu edhe në buletin ditor të Ministrisë së Jashtme të Austro-Hungarisë me rastin e vizitës së Ismail Qemalit, theksohej fakti se ata [diplomatët vjenezë] u treguan tepër të përmbajtur dhe të kujdesshëm në përgjigjet që i dhanë Ismail Qemalit për të ardhmen politike të Shqipërisë, duke u ku-

besueshëm nga konsujt austro-hungarezë dhe cilësohej si rivali politik i Syrja bej Vlorës që ishte politikani shqiptar që gëzonte mbështetjen e diplomacisë vjenezë.

¹⁷ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze*, vëll. VI, f.163.

¹⁸ Ilir Ikonimi, *Pavarësia, udhëtim i paharruar i Ismail Qemalit*, f. 86. Baronesha bavareze Amelie von Godin që në nëntor 1912 gjendej në Vlorë, në punimin e saj ka shprehur mendimin se Ismail Qemali shkoi nga Bukureshti në Vjenë i nxitur nga njoftimet se atje ishte Eqerem bej Vlorë.

fizuar më së shumti vetëm me deklarata të përgjithshme dhe jo specifike¹⁹. Në intervistën dhënë nga Ismail Qemali gazetës “NEUE FREIE PRESSE” në Vjenë në nëntor 1912, gjejmë shprehje pikëpamjet e tij rreth së ardhmes politike të Shqipërisë për krijimin e shtetit të pavarur shqiptar. Si përgjigje ndaj pyetjes së bërë nga gazetari austriak rreth kryeqytetit të Shqipërisë, me interes është përgjigja e Ismail Qemalit, i cili përmend Elbasanin dhe Vlorën, duke u shprehur përmes fjalëve: *Elbasani mund të ishte Uashingtoni, ndërsa Vlora, Nju Jorku ynë*²⁰.

Në telegramin dërguar nga Vjena më 12 nëntor 1912, Ismail Qemali deklaronte se e ardhmja e Shqipërisë ishte garantuar. Përmbajtja e këtij telegrami iu dërgua menjëherë qyteteve shqiptare, duke u kërkuar parisë së tyre dërgimin e menjëhershëm të delegatëve për në Vlorë. Por, në telegramin dërguar shqiptarëve të kolonisë së Bukureshtit në të njëjtën ditë [para se ai të nisej për në Budapest për të takuar kontin Berchtold], Ismail Qemali shprehte besimin se me mbështetjen e Austrisë, Italisë dhe Rumanisë autonomia ishte siguruar²¹.

Në Budapest, ngjarja më e rëndësishme ishte takimi i Ismail Qemali me kontin Berchtold më 13 nëntor 1912, ku për nga rëndësia që pati, ky takim u mbajt i fshehtë dhe nuk pati asnjë njoftim zyrtar, madje as zyrtarët e lartë austriakë nuk guxonin ta përmendnin. Pavarësisht kësaj, takimi midis tyre u bë i njohur për herë të parë nga vetë Ismail Qemali, në kontaktin që ai pati me nënkonsullin Rudnay sapo zbriti në Durrës më 22 nëntor 1912²². Sipas tij, Konti Berchtold i kishte dhënë garanci të plota Ismail Qemalit për mbështetjen e Vjenës zyrtare, duke i kërkuar shpalljen sa më shpejt të ishte e mundur të pavarësisë së Shqipërisë. Mendojmë se e rëndësishme për diplomacinë vjeneze tashmë ishte krijimi i një shteti të pavarur shqiptar, pavarësisht se kush do të arrinte ta krijonte i pari atë, Syrja bej Vlora apo Ismail Qemali, duke frenuar në këtë mënyrë rrezikun e pushtimit të porteve shqiptare nga serbët dhe daljen e tyre në Adriatik.

Pjesa më interesante e bisedës ndërmjet Ismail Qemalit dhe Berchtold-it na vjen përmes kujtimeve të At Anton Harapit, përkthyes për austriakët:

¹⁹ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze*, vëll. VI, f. 162.

²⁰ Ilir Ikononi, *Pavarësia, udhëtim i paharruar i Ismail Qemalit*, f. 97.

²¹ Po aty, f. 122. Ndërkohë që në 12 nëntor 1912 Ismail Qemali i njoftonte shqiptarët e Bukureshtit për sigurimin e autonomisë, disa ditë më parë, në 8 nëntor 1912, Ismail Qemali, në intervistën dhënë gazetës vjeneze *NEUE FREIE PRESSE*, ishte shprehur për pavarësinë e Shqipërisë.

²² Ilir Ikononi, *Pavarësia, udhëtim i paharruar i Ismail Qemalit*, f.184.

*Berchtoldi i parashtrroi Ismail Qemal Beut që të delte sa më parë në Shqipni për të shpallë pamvarësinë. Ismaili iu përgjegj: 'Mir se flamurin e kam, por nuk kam shtizën ku ta naltoj dhe flamurin pa shtizë e merr çdo erë që fryn. Atëherë Konti Berchtold iu përgjegj: Për shtizë të këtij flamuri keni bajonetën austriake*²³. Në një kontekst të tillë duhet parë edhe telegrami që Ismail Qemali dërgoi nga Budapesti më 16-17 nëntor 1912, ku njoftonte se së shpejti do të ishte në Durrës, duke kërkuar që delegatët e caktuar për në kuvendin kombëtar të mbledheshin në Durrës ose në Vlorë²⁴.

Në nëntor të vitit 1912, kur edhe Ismail Qemali kishte marrë mbështetjen dhe garanci të plotë nga diplomacia vjeneze, rivaliteti politik ndërmjet Ismail Qemalit dhe Syrja bej Vlorës qëndronte në çështjen se cili prej tyre do të mund të siguronte sa më shpejt dhe në momentin e duhur, mbështetjen më të madhe brenda vendit, në funksion të përmbushjes të të njëjtit qëllim si synim final, thirrjen e një kuvendi kombëtar. Ismail Qemali dhe Syrja bej Vlora po shfrytëzonin të gjitha njohjet dhe reputacionin e tyre për zgjidhjen e çështjes shqiptare, por, pa bashkëpunuar me njëri-tjetrin. Kushërinjtë ishin dy burra të mençur dhe nuk lejonin që rivaliteti t'iu infektonte dëshirën për ta parë racën e tyre të çliruar dhe të begatë²⁵. Por, Ismail Qemali dhe Syrja bej Vlora, më shumë se kushërinj, ishin rivalë me një histori të vjetër. Në parlamentin e ri xhonturk të vitit 1912, Syrja bej Vlora ishte zgjedhur deputet i sanxhakut të Beratit, në të cilin përfshihej kazaja e Vlorës, pavarësisht se ai nuk jetonte në Vlorë. Ndryshe nga Ismail Qemali, ai i përkiste partisë xhonturke dhe e kishte marrë mandatin me përkrahjen e tyre²⁶. Mendojmë se kjo është arsyeja e mbështetjes së pakët dhe kundërshtive që gjeti Syrja beu dhe i biri i tij, në përpjekjet për organizimin e kuvendit kombëtar në Vlorë në nëntor 1912. Përpjekjet e Syrja bej Vlorës, kishin hasur në kundërshtimin e një pjese të parisë së Vlorës. Elmas efendi Kanina dhe Adem bej Risilia e akuzonin atë si të shitur tek austriakët. Madje, sipas Eqerem bej Vlorës, grupi kundërshtar kishte njoftuar edhe autoritetet osmane që pavarësisht se nuk morën masa kundër Syrja beut, e paralajmëruan atë për pasojat që mund të kishte vijimësia e veprimtarisë së tij në favor të çështjes shqiptare²⁷.

²³ Po aty, f. 135.

²⁴ Po aty, f. 152.

²⁵ Ilir Ikononi, *Pavarësia, udhëtim i paharruar i Ismail Qemalit*, f. 42.

²⁶ Po aty, f. 41.

²⁷ Po aty, f. 49.

Në këto rrethana, organizimi i kuvendit kombëtar nga Syrja beu në qytetin e Vlorës ishte jo vetëm i vështirë, por edhe i pamundur. Mundësia e vetme mbetej që kuvendi të organizohej në Shqipërinë e Mesme. Sugjerimet e parashtruara në këtë drejtim parashikonin mundësinë e mbledhjes së kuvendit kombëtar në një nga qytetet më kryesore të Shqipërisë së Mesme, sikurse ishin: *Tirana, Durrësi, Kruja, Elbasani*.

Dështimi i përpjekjeve për organizimin e Kuvendin Kombëtar në Durrës

Si qyteti më i përshtatshëm nga organizatorët e kuvendit kombëtar fillimisht u mendua Durrësi, kjo edhe për faktin se atje, Syrja bej Vlora dhe përkrahësit e tij gëzonin gjithashtu edhe mbështetjen e plotë të nënkonsullit austro-hungarez Ludvig von Rudnay.

Më 12 nëntor 1912, sapo u njoftua për mbledhjen e një kongresi kombëtar në Durrës, kundërshtitë nga hoxhallarët dhe pjesës më fanatike të popullsisë së qytetit ishin aq të mëdha, sa e bënë të pamundur zhvillimin e tij. Në kërkesën drejtuar mytesarifit, hoxhallarët kërkuan dëbimin e delegatëve, ndërsa pjesa më radikale e qytetarëve e konsideronte mbajtjen e kongresit si një rrezik serioz për stabilitetin e Kalifit²⁸. Të njëjtin qëndrim me ta mbajti edhe popullsia ortodokse e qytetit të Durrësit. Ishte mëse e kuptueshme se në këto kushte, kuvendi kombëtar nuk mund të mbledhej.

Pavarësisht situatës së krijuar, diplomacia vjeneze nuk kishte qëndruar duarkryq. Përpjekjet e konsullit austro-hungarez në Durrës Ludvig von Rudnay vijuan në fshehtësi. Delegatët shqiptarë që kishin ardhur në Durrës, ishin grumbulluar në kryepeshkopatën katolike që drejtohej nga dom Nikollë Kaçorri (një prift katolik me nënë myslimane), dhe që mbante lidhje të ngushta me konsullatën austriake²⁹. Referuar burimeve austro-hungareze, rezultoi se takimi është zhvilluar më 12 nëntor të vitit 1912. Në të ishin të pranishëm: Dom Nikollë Kaçorri, Mustafa Asim Kruja,

Rexhep Mitrovica, Fuad Toptani, Abdi Toptani, Murad Toptani, Sali Gjujka nga Peja, Bedri Pejani.³⁰

Nënkonsulli austro-hungarez i propozoi delegatëve nënshkrimin e një dokumenti, përmes të cilit të kërkohej “autonomia” nën sovranitetin turk,

²⁸ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze*, vëll. VI, f. 172.

²⁹ Ilir Ikonimi, *Pavarësia, udhëtim i paharruar i Ismail Qemalit*, 109.

³⁰ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze*, vëll. VI, f. 177.

ose “pavarësia dhe neutraliteti”, në pamundësi të autonomisë. Referuar informacionit të nënkonsullit Rudnay, kërkesa e pavarësisë dhe neutraliteti i parashtruar në këtë dokument, ishte bërë më së shumti për të ruajtur balancat, sepse, në rast të kundërt, nuk do të mund të arrihej një marrëveshje me delegatët e pranishëm në Durrës. *Kjo kërkesë duhej t’i drejtohej Madhërisë së tij, Imperatorit dhe Mbretit*, - sikurse shkruante nënkonsulli austriak në Durrës, Rudnay, duke shpresuar që më 13 nëntor 1912 ai do ta kishte këtë dokument të firmosur³¹. Sipas tij, ky dokument mund të përdorej në një kohë tjetër, në varësi të rrethanave që do të krijoheshin, por pa i premtuar shqiptarëve detyrime apo angazhime zyrtare nga ana e Vjenës.

Pas propozimit që nënkonsulli austriak i parashtroi dom Nikollë Kaçorrit dhe Murad bej Toptanit në takimin që ai pati me ta dhe delegatët e tjerë të pranishëm, nënshkrimi i deklaratës u pranua. Në këtë deklaratë paraqitej kërkesa e përfaqësuesve shqiptarë të mbledhur në Durrës, për autonomi nën sovranitetin turk dhe në rast se kjo nuk do të ishte e mundur, kërkesa për pavarësi dhe neutralitet. Një kërkesë e tillë i drejtohej posaçërisht:

*Madhërisë së Tij,
Franc Jozefit I,
Perandorit e Mbretit të Austro - Magjuriës në
Vienë³²*

Theksojmë se nënshkruesit e kësaj deklarate ishin përfaqësuesit e mbledhur në Durrës në pritje të organizimit të kuvendit kombëtar nga Syrja bej Vlora dhe Eqerem bej Vlora³³. Në takimin në Durrës ka qenë prezent edhe Midhat Frashëri, i cili pavarësisht se ka qenë dakord me deklaratën, nuk e ka vënë nënshkrimin e tij³⁴. Burimet e konsultuara nuk na japin ndonjë informacion se përse Midhat Frashëri nuk e ka nënshkruar deklaratën, pavarësisht dakordësisë së shprehur.

³¹ Po aty.

³² *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze*, vëll. VI,, 172-173.

³³ Po aty, f. 177. Nënshkruesit e deklaratës ishin: Nikoll Kaçorri, Mustafa Asim Kruja, Rexhep Mitrovica, Fuad Toptani, Abdi Toptani, Murad Toptani, Sali Gjuka nga Peja dhe Bedri Pejani. Ndërsa Syrja bej Vlora në 12 nëntor ishte nisur për në Vjenë dhe Eqerem bej Vlora, sipas konsullit austriak në Vlorë, ishte nisur nga Vlora për në Durrës.

³⁴ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze*, vëll. VI, vepër e cituar, f. 174.

Në raportin tepër konfidencial të nënkonsullit Rudnay, dërguar për këtë problem kontit Berchtold në Vjenë, thuhej: *Edhe një herë marr lejen të njoftoj tepër përvujtërisht se unë vendimin për këtë hap e mora për rastin, që, edhe në qoftë se do të dështonte mbledhja e kongresit, ne të posedonim një dokument prej parisë shqiptare, i cili pa na ngarkuar ne me detyrime, mund të përdorej në situatë të veçanta*³⁵. Referuar këtij informacioni, mendojmë se nënshkrimi i dokumentit në fjalë ishte një nismë vetjake e nënkonsullit Rudnay, pa dijeninë e Vjenës zyrtare, duke përjashtuar çdo lloj detyrimi të Vjenës zyrtare ndaj Shqipërisë. Mendimi ynë përforcohet edhe më tepër duke iu referuar përgjigjes që konti Berchtold në Vjenë do t'i kthente brenda së njëjtës ditë nënkonsullit Rudnay. Ai e këshillonte nënkonsullin Rudnay, që në vend të nismave të tilla me personalitetet shqiptare, të arrinte t'i këshillonte ata që, përmes shtypit, t'i drejtoheshin opinionit publik evropian, për të treguar vendosmërinë dhe vullnetin kombëtar për ruajtjen e integritetit territorial kombëtar³⁶. Gjithashtu, mendojmë se nënkonsulli Rudnay nuk ka qenë i informuar zyrtarisht nga Vjena zyrtare për takimin e Ismail Qemalit me kontin Berchtold.

Për sa i përket çështjeve që janë diskutuar në takimin e organizuar në Durrës, një informacion më të plotë e gjejmë në kujtimet e Mustafa Asim Krujës (Mustafa Merlika)³⁷. Përmes kujtimeve të tij informohemi rreth disa propozimeve nga të pranishmit, ndër të cilat, edhe kërkesa drejtuar perandorit austro-hungarez që Shqipëria të bëhej një shtet federativ si Zvicra apo Amerika. Në kujtimet e tij, Mustafa Kruja e konsideronte si interesant propozimin e Salih Gjokës, i cili, duke dhënë argumente politike dhe historike, kërkonte që Shqipëria e ardhshme të vihej nën protektoratin e Austro-Hungarisë. Kjo kërkesë e një myslimani, - kujtonte Mustafa Kruja, çuditërisht u kundërshtua nga prifti katolik dom Nikollë Kaçorri, që kishte një simpati të madhe për Austro-Hungarinë dhe gëzonte gjithashtu përkrahjen e konsujve austro-hungarezë. Përmes parashtrimit të argumentit se në koniunkturat e reja të krijuara, Perandoria Otomane ose i "Sëmuri i Bosforit" nuk e kishte jetën të gjatë, zgjidhja më e mirë sipas Dom Nikollë Kaçorrit, do të ishte autonomia

³⁵ Arkiva e Institutit të Historisë (më tej *AIH*). VJ. 22-8-826; 22-11-1153. *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze*, vëll. VI, f. 174-175.

³⁶ *AIH*, VJ. 22-11-1151. *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze*, vëll. VI, f. 180.

³⁷ Në dokumentet austro-hungareze Mustafa Merlika rezulton me emrin Mustafa Asim Kruja. Gjithashtu, edhe në dokumentin e pavarësisë së Shqipërisë gjendet nënshkrimi Mustafa Asim Kruja.

nën Perandorinë Otomane, me rënien e së cilës do të ishte më e lehtë të arrihej pavarësia³⁸.

Parashtrimi në këtë mbledhje i disa alternativave rreth perspektivës së shtetit shqiptar [në rrethanat e reja të krijuara në nëntor të vitit 1912] dhe, për më tepër, kur një mysliman kërkonte shkëputjen nga Perandoria Otomane dhe një katolik kërkonte të qëndronte akoma nën sulltanin, janë tregues i faktit se përfaqësuesit shqiptarë në mbledhjen e organizuar në kryepeshkopatën katolike në Durrës, në propozimet e tyre, më së shumti gjykonin si politikanë vizionarë, duke parashtruar alternativën më të mirë të mundshme për të ardhmen e Shqipërisë, sikurse shprehej dhe Mustafa Kruja: *...te patrijoti intelektual shqiptar ndienja e ideja e kombisë qëndronte përmbi ato të fesë*³⁹.

Gjithsesi, kuvendi kombëtar nuk arriti të mbledhjet në Durrës, ndaj organizatorët dhe delegatët që gjendeshin atje menduan si zgjidhje të shkonin drejt Tiranës, për të parë mundësinë e organizimit atje të kongresit⁴⁰. Por, përparimi i shpejtë i ushtrisë serbe drejt Durrësit dhe Tiranës e bëri të pamundur organizimin e kuvendit edhe në Tiranë.

Elbasani në pritje të organizimit të Kuvendit Kombëtar më 14 nëntor 1912

Në kujtimet e tij, Midhat Frashëri do të shkruante: *Atëhere, duke u-lenë me një anë Tiranë dhe Durrësi, vështrimet u këthyenë drejt Elbasanit*⁴¹. Duke përmendur traditat patriotike të këtij qyteti dhe faktin se edhe më parë në Elbasan ishin organizuar kuvende kombëtare, ai theksonte se në Elbasan ishte më e lehtë që të mbledheshin delegatët, duke pasur gjithashtu edhe mbështetjen e parisë vendase. Ndaj, në pamundësi të mbajtjes së Kuvendit Kombëtar të planifikuar për në Durrës apo Tiranë, Elbasani konsiderohej si qyteti më i përshtatshëm për organizimin e tij.

Midhat Frashëri ishte i mendimit që kuvendi mund të mbahej në Elbasan, në kërthizën e Shqipërisë, ashtu siç e kishin pleqëruar edhe me imzot Preng

³⁸ Mustafa Merlika Kruja. *Anthologji Historike*. (Elbasan, Sejko, 2001)267-269.

³⁹ Po aty, f. 269.

⁴⁰ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze*, vëll. VI, f. 193. Njoftimi për të nisur delegatët drejt Tiranës i ishte dërguar edhe Esad pashë Toptanit që ishte në Shkodër, i cili e kishte dhënë miratimin e tij.

⁴¹ K. Frashëri. *Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë*, f. 243. Kujtime nga Midhat Frashëri. *Javët e fundit të sundimit Osman në Shqipëri*.

Doçin, duke u nisur edhe vetë nga Durrësi drejt Elbasanit⁴². Në nëntor të vitit 1912 ai u nis për në Elbasan, duke u vendosur në shtëpinë e Aqif Pashë Biçakut. Në Elbasan, ku ai gjeti Mahmut pashë Jellën, të cilin e kishte takuar në Shkup dhe në Pejë, u informua edhe për tejshkrimet që kishin ardhur nga Mehmet pashë Dërralla, Zenel Peja, Riza Jakova, Isa Boletini, Bajram Curri etj., të cilët i kishte njoftuar për të ardhur në Elbasan për mbledhjen që do të bëhej⁴³.

Referuar nënkonsullit austriak në Durrës, më 14 nëntor të vitit 1912, Elbasani ishte njoftuar për të bërë përgatitjet e duhura për organizimin e Kuvendit Kombëtar në funksion të përmbushjes së këtij qëllimi madhor, duke i raportuar eprorëve të tij: *Ftesa në këtë drejtim janë bërë*⁴⁴. Midhat Frashëri pohonte se Elbasani jo vetëm që kishte marrë njoftimin, por, gjithashtu, kishte nisur kontaktet me qytetet e tjera, duke u shprehur: *Tek Elbasani zgjidhte përfaqësonjësit e tij dhe këmbente mëndimetë me qendrat e tjera, na se ku po faqetë një çështje e re ...*⁴⁵.

Njoftimet për përparimin e shpejtë të ushtrisë serbe dhe mbërritjen e saj në Ohër dhe Strugë, përbënin një rrezik që shumë shpejt mund t'i kanosej edhe Elbasanit, sikurse shprehej Midhat Frashëri: *Serbët janë tue zbriturë në Ohër dhe në Strugë, telegrafi është në rrezik të pritë*⁴⁶. Në këtë kuadër, jemi të prirë të mendojmë se faktorët që e privuan edhe Elbasanin nga kjo ngjarje me dimensione mbarëkombëtare, midis të tjerave, lidhen edhe me mungesën në këtë qytet të konsullatave të huaja dhe të lidhjeve telegrafike të Elbasanit me botën e jashtme. Kur bëjmë një pohim të tillë i referohemi edhe pohimit të Midhat Frashërit i cili shprehej se: *Në rast të sulmit të qytetit të Elbasanit nga ushtria serbe, qyteti i zgjedhur si vendi i mbledhjes jo vetëm që ishte i hapur [i ekspozuar] ndaj pushtimit, por edhe pa mjet komunikimi me botën e jashtme, që e bënte tashmë të pamundur mbajtjen e kongresit në Elbasan*⁴⁷. Mendojmë që këto përbënin edhe arsytet më kryesore pse plani për të organizuar kuvendin kombëtar në Elbasan mbeti një projekt i parealizuar.

⁴² Instituti i Studimeve Historike “Lumo Skëndo”, Midhat Frashëri (*Lumo Skëndo*), *Vepra të zgjedhura*, vëll. I. (Përgatitur për botim nga Uran Butka), Tiranë, 2017, f. 35.

⁴³ Instituti i Studimeve Historike “Lumo Skëndo”, Midhat Frashëri (*Lumo Skëndo*), *Vepra të zgjedhura*, vëll. I. Përgatitur për botim nga Uran Butka, f. 35.

⁴⁴ *Shqipëria në dokumentet austro-hungareze*, vëll. VI, f. 191.

⁴⁵ K. Frashëri. *Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë*, Tiranë, “Kristalina – KH”, 2008, f. 243.

⁴⁶ K. Frashëri. *Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë*, f. 243.

⁴⁷ Po aty.

Ndërkaq, me mbërritjen e Ismail Qemalit në Durrës, edhe ai sikurse kushëriri i tij Syrja bej Vlora, nuk mundi ta mbledhë kuvendin kombëtar në atë qytet, pikërisht, po për të njëjtat arsye që penguan edhe Syrja Bej Vlorën. Pas dështimit të përpjekjeve të Syrja bej Vlorës për organizimin dhe lajmërimin e delegatëve për në Kongresin Kombëtar, tashmë në Vlorë ishte krijuar një Komitet Organizator që drejtohej nga kushëriri i tij Xhemil bej Vlora, por që ishte përkrahës i Ismail Qemalit. Me nisjen e udhëtimit të Ismail Qemalit nga Durrësi për në Vlorë, ku ishin nisur edhe pjesa më e madhe e delegatëve nga trevat shqiptare, ishte e qartë se Kuvendi do të mbledhej në Vlorë, por nën drejtimin e Ismail Qemalit dhe jo të Syrja bej Vlorës, i cili për hir të së vërtetës, duhet thënë se nuk e gëzonte mbështetjen e duhur në atë qytet, edhe pse ishte qyteti i tij i lindjes, pavarësisht edhe përpjekjeve të Eqerem bej Vlorës.

Ismail Qemali mbërriti në Vlorë në 26 nëntor 1912, duke pasur si qëllim mbledhjen e Kuvendit Kombëtar. Në telegramin që Lef Nosi u dërgoi parisë së Elbasanit nga Vlora më 27 nëntor 1912, ai i informonte ata për zhvillimet e pritshme lidhur me kongresin kombëtar, duke i njoftuar se: *“Nesër në mëngjes kongresi do të shpalli Indipendencën e Shqipëniës edhe do t’ia komunikojë Shteteve të Mëdha; do të formohet Qeveria e Përkohshme e do të zgjidhen pjesëtarët e saj. Austria, Gjermania, Italia dhe Rumania janë zotuar ta njohin këtë rrugë që po ndjekim. Nga lajmet e ardhura këtu, merret vesht se në shumë qytete të Shqipënis është shpall Indipendenca. Ndihma e ushtrisë së Janinës u siguro. Sepse gjithkush e kuptoi se përveç Indipendencës, tjetër mjet shpëtimi nuk ka. Mustafëzët e vullnetarët që janë në Himarë ngritën flamurin shqiptar kundrejt anmikut”*⁴⁸.

Përfundime

Kuvendi Kombëtar u hap më 28 nëntor të vitit 1912 në shtëpinë e Xhemil Bej Vlorës, pa pritur ardhjen e të gjithë delegatëve nga qytetet shqiptare dhe nën drejtimin e Ismail Qemalit. Eqerem Bej Vlora nuk u bë pjesë e këtij Kuvendi Historik. Të dy kushërinjtë e fisit të Vlorajve bënë përpjekjet maksimale për organizimin e Kuvendit Kombëtar dhe çështjen kombëtare në vitin 1912, por pa bashkëpunuar ndërmjet tyre, pavarësisht se i bashkonte i njëjti qëllim. Rivalitetet personale dhe politike ndërmjet tyre ishin më të fuqishme se sa lidhjet fisnore. Syrja bej Vlora përfaqësonte në parlamentin Osman Partinë

⁴⁸ IH, *Dokumenta Historike...*, TR, 2007, 14 vjeshtë e III-të 1328/1912. 93.

Xhonturke, ndërsa Ismail Qemali opozitën qeveritare. Ndërkaq, mendojmë se rivalitetet ndërmjet përfaqësuesve të elitës politike shqiptare ishin karakteristike e shoqërisë shqiptare të asaj kohe dhe më pas, ku duhet thënë se pushteti politik nga 1912 e në vazhdim dominohej nga shtresa konservatore shqiptare, përfaqësues të dyerve të Mëdha feudale, ndërsa, shtresa e re e borgjezisë – intelektuale shqiptare ishte në minorancë.

Në këndvështrimin e sotëm, është e shpjegueshme ekzistenca e rivaliteteve të tilla politike, por në momente të caktuara historike, kur fati dhe e ardhmja e vendit është në rrezik, politika dhe politikanët duhet të bëhen bashkë për hir të një interesi më madhor, interesit kombëtar. Ndaj, në rrethanat e krijuara në vitin 1912, edhe pse rrezikohej seriozisht shpallja e pavarësisë dhe krijimi i shtetit të pavarur shqiptar, për një pjesë të kësaj elite politike, interesat personale prevaluan ndaj interesave kombëtare, tipar ky i elitës politikës shqiptare edhe në periudhat e mëvonshme shtetformuese shqiptare.

Bibliografi:**Burimet arkivore:****Arkivi Qendror Shqiptarë (AQSH)- Fondi nr. 56 (Syrja VlorA):**

- AQSH. Fondi. 56, Syrja Vlorë. Dos. nr. 61, dok. 30743.
- AQSH. Fondi. 56, Syrja Vlorë. Dos. nr. 27, fl. 1-4.
- AQSH. Fondi.56, Syrja Vlorë. Dos. nr. 61, fl. 1-2.
- AQSH. Fondi . 145. Dos. nr. II-27, fl. 11.

Arkivi i Institutit të Historisë:

- AIH- Fondi: Haus, Hof und Staatsarchiv Wien, Politisches Archiv, Albanien,, VJ. 22-8-826; 22-11-1153.
- AIH, Dokumente Historike..., TR, 2007, 14 vjeshtë e III-të 1328/1912. 93

Burime të botuara:

- *Midhat Frashëri (Lumo Skëndo)*, vepra të zgjedhura, vëll. I. (Përgatitur për botim nga Uran Butka.) Instituti i Studimeve Historike “Lumo Skëndo”, Tiranë: 2017.

Literatura:

- *Shqipëria në Dokumentet Austro-Hungareze Vëll.VI* (Përgatiti për botim Marenglen Verli e Ledia Dushku), Botimet Albanologjike, Tiranë: 2012.
- VLORA, Syrja. *Kujtime nga fundi i sundimit Osman deri në Luftën e Vlorës*. (Përgatiti për botim Verli Mariglen & Dushku, Ledia. Iceberg publishing house, Tiranë: 2013.
- KRUIA, Mustafa Merlika. *Anthologji Historike*, Sejko, Elbasan: 2001.
- IKONOMI, Ilir. *Pavarësia, udhëtim i paharruar i Ismail Qemalit*, UET Press, Tiranë: 2012.
- FRASHËRI, Kristo. *Shpallja e Pavarësisë së Shqipërisë, “Kristalina – KH”*, Tiranë: 2008.
- VLORA bej, Eqërem. *Kujtime, vëllimi i parë 1885-1912, Shtëpia e Librit dhe Komunikimit*, Tiranë: 2001.
- VERLI, Marenglen. *Shqiptarët në optikën e Diplomacisë Austro-Hungareze 1877-1918*, (Studime, analiza, dokumente), Botimet “Klean”, Tiranë: 2014.
- AVLONYALI Süreya Bey, *Osmanlı Sonrası Arnavutluk (1912-1920)*, Hazirlyayan: A. Kırmızı, Klasik Yayınları Istanbul: 2009.
- NOSI, Lef. *Dokumente historike për t’i shërbyer historisë shqiptare*, Tiranë: 1937.

Majlinda PEZA-PERRIU

European University of Tirana

Email: majlinda.perriu@uet.edu.al

ORCID: [https:// orcid.org/0000-0002-4846-7609](https://orcid.org/0000-0002-4846-7609)

KUD: 32:929(496.5)Vlora, familje(05)

&

Ilirjana KACELI-DEMIRLIKA

The Luigj Gurakuqi University of Shkodër

Email: ilirakaceli@gmail.com

ORCID: <https://orcid.org/0000-0002-8228-9789>

KUD: 32:929(496.5)Vlora, familje(05)

SUMMARY**THE POLITICAL AND DIPLOMATIC ACTIVITY
OF THE VLORA FAMILY ON THE EVE OF ALBANIA'S I
NDEPENDENCE**

This study examines the project of Syrja Bey Vlora to organize a National Assembly in November 1912, as an alternative initiative to Ismail Kemal Bey Vlora's movement for the declaration of Albanian independence. Based on archival sources from Austro-Hungarian, Italian, and Ottoman consulates, the research reveals that Syrja Bey, known for his close ties to the Ottoman administration and his political influence in Vlora, aimed to convene an assembly of Albanian representatives under Ottoman supervision, with the goal of maintaining autonomy within the Empire. The paper analyzes this initiative within the context of the political and diplomatic rivalry between the two leading figures of Vlora, highlighting the contrast between the vision of full independence and that of Ottoman autonomy. Ultimately, the study portrays Syrja Bey as a complex historical figure who, despite the failure of his project, contributed in his own way to the shaping of the Albanian statehood process.